

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHIOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: “Sib – Bka” Sh.p.k. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	24.03.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës: 23.03.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Sib - Bka” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME**, me Numër të prokurimit: 623-20-775-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Sib - Bka” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME**, me Numër të prokurimit: 623-20-775-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 11.03.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME**, me Numër të prokurimit: 623-20-775-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: “Sib - Bka” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME**, me Numër të prokurimit: **623-20-775-2-1-1**, Nr. i brendshëm: **623-20-001-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: 11.03.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 23.03.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, në cilin pretendon se janë shkelur këto nenet:

- **Neni 1** i LPP-së – Qëllimi
- **Neni 6** i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- **Neni 7** i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Autoriteti Kontraktues hedh poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se AK Komuna e Rahovecit ka vepruar duke u bazuar së pari në Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kriteret duke e respektuar në përgjithësi Ligjin e Prokurimit Publik dhe ne veçanti Nenin 7– Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, duke vendosur kriteret që nuk janë diskriminuese dhe duke mos ngushtuar aftësinë e konkurruese të Operatorëve Ekonomik, dhe duke u bazuar te kriteret e Autoriteteve tjera Kontraktuese ku nuk e ka kufizuar konkurrencën.

Autoriteti Kontraktues ka vendosur kriteret duke u bazuar në natyrën e aktivitetit të prokurimit duke kërkuar nga Operator Ekonomik profesionale marrjen e shërbimeve kualitative pasi që kemi të bëjmë me hartimin e projekteve të ndryshme sipas kërkesave të njëjësive brenda AK-së.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit